



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva



KËSHILLI KOMUNAL PËR SIGURI NË BASHKËSI

EKSTRAKT

nga procesverbali i mbajtur më 26 tetor 2016, në mbledhjen e pestë të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi

Mbledhja u mbajt në sallën nr. 31 dhe filloi në orën 10.00

Në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, mbledhjen e hapi dhe kryesoi z. Nexhmi Rudari Nënkyetar Komunës.

Fillimisht u vërtetua se në mbledhje ishin të pranishëm: z. Bekim Bislimi, Komandant i Stacionit të Policisë; z. Bekim Jashari, përfaqësues i Këshillit të Bashkësisë Islam; z. Radisav Perović, përfaqësues i Komunitetit serb; z. Shaban Ahmeti, kryesues i Komitetit për Komunitete; znj. Naime Podvorica, zyrtare për Barazi Gjinore; z. Avni Maloku, drejtor i Drejtorisë së Arsimit; z. Sami Ajeti, kryetar i Këshillit të Prindërve të Arsimit në Nivel komunal; z. Naim Bajraktari, kapiten, përfaqësues i FSK-së; z. Rizah Muçolli, kryesues i Ekipit Veprues për Siguri në Bashkësi; z. Faik Muçiqi, përfaqësues i Emergjencave Civile; z. Liman Zeqiri, përfaqësues i Zyrës Komunale për Komunitete dhe Kthim; z. Bunjamin Hoti, përfaqësues i OJQ-ve; z. Fadil Halimi, përfaqësues i Mediave lokale; z. Avni Shabani, përfaqësues i Komunitetit të biznesit dhe z. Idriz Hoxha, përfaqësues i komunitetit të personave me nevoja të veçanta.

Me këtë u konstatua se ekziston kuorumi.

Në mbledhje ishin të pranishëm edhe: z. Ylber Salihu, zyrtar për integritet evropian në Komunën e Podujevës; Përfaqësuesi i KFOR-it dhe përfaqësuesit e OSBE-së.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fillimisht më lejoni të ju informoj që mbledhjen e sotme të Këshillit do ta kryesoj unë në mungesë të Kryetarit të Komunës z. Agim Veliu, i cili për çështje objektive është i zënë. Ju falënderoj dhe ju shpreh mirëseardhje në takimin e sotëm. Rendin e ditës me materialet besoj i keni marrë me kohë. Nëse jeni dakord mund të fillojmë me punë.

1. Rend i propozuar i ditës

U miratua njëzëri.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 15 shtator 2016

U miratua njëzëri

3. Raporte të Policisë së Kosovës dhe KFOR-it për gjendjen e sigurisë në Komunë

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fjalën e ka Komandanti i Stacionit të Policisë z. Bekim Bislimi.

z. Bekim Bislimi, gjendja e sigurisë në Komunën e Podujevës, bazuar në zhvillimet e deritanishme konsideroj se është e qetë dhe nuk pritet ndonjë ndryshim në të ardhmen. Numri i veprave penale dhe iniciimi i rasteve në Stacionin Policor është i një trendi në rritje, por jo në shkallë të madhe. Në periudhën nëntë mujore kemi afër 100 raste më shumë të iniciuara në raport me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Edhe në takimin e kaluar kemi potencuar se në rajonin e Podujevës ka indicje për

kultivimin e substancave narkotike, përkatësisht kanabis sativa . Rasti i fundit ishte në fshatin Lupç, ku nga Njësia Anti Drogë janë shkatërruar 912 fije kanabis. Sa i përket sigurisë nëpër shkolla në vazhdimësi jemi duke punuar në identifikimin dhe parandalimin e problemeve që mund të ndikojnë në sigurinë e nxënësve. Javën e fundit nga zyrtarët policor që operojnë në rroba civile në bashkëpunim me personelin e SHMT “ Fan S. Noli“ janë gjetur dhe konfiskuar një revole, një mull për bluarjen e kanabisit si dhe mjete të forta (thika, boks të metalit). Çështjen e sigurisë së përgjithshme por edhe atë nëpër shkolla e kemi diskutuar në takimet me KLSB-të në fshatrat Orllan dhe Kërpimeh. Në këtë kontekst kërkoj nga të gjithë një angazhim dhe bashkëpunim me Policinë në raport nxënës-prind – mësimdhënës. Në takimet me KLSB-të është adresuar një kërkesë që i referohet pamundësisë së shfrytëzimit të pronave nga shtetasit tanë që i kanë në territorin e Serbisë.

Në takimin e kaluar nga ana e Këshillit është aprovuar projekti për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet. Ju informoj se në bashkëpunim me zyrtarin e TI-së të Komunës kemi përgatitur projektin dhe mbetet që të prezantohet kur të krijohen kushtet nga Kuvendi komunal.

Sa i përket komunikacionit, besoj se nga Drejtoria kompetente është identifikuar pika që gjendet në fshatin Surkish, përkatësisht në udhëkryqin që lidh rrugën për në fshatin Sfeçël. Për shkak të konfiguracionit dhe ndërtimit shumë afër rrugës në atë lokacion kemi raste të aksidenteve me lëndime, por edhe me fatalitet. Konsideroj të nevojshme vlerësimin e ekspertëve të komunikacionit për ndërmarrjen e hapave të nevojshëm për këtë çështje.

Ndërsa sa i përket emërtimeve të reja të rrugëve, javën e kaluar kemi kërkuar një listë të këtyre emërtimeve, por ende nuk kemi pranuar asgjë, meqë ka probleme gjatë reagimit të njësive policore në lokacione të caktuara, në rastet kur kërkohet, por edhe në procedurat tjera kur inicohet rasti. Kjo ishte sa i përket raportit, nëse keni ndonjë pyetje jam i gatshëm të përgjigjem.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, komandanti ngriti tri shqetësime që janë shqetësime të të gjithë neve, çështja e sigurisë nëpër shkolla, për këtë do ta kemi një informatë nga Drejtori i Drejtorisë së Arsimit-DA. Çështja e kërkesave të banorëve në pjesën e epërme të lumit Llap që kanë prona në Serbi, kjo nuk është në kompetencë të Komunës, me siguri se do të jetë çështje e debateve dhe dialogut në mes shtetit të Kosovës dhe shtetit të Serbisë dhe çështja për vendosjen e kamerave të sigurisë në qytet. Përveç komunikacionit që është bërë si pikë e zezë edhe pse me ligjin e ri janë ashpërsuar dënimet dhe sipas mediave kanë pas ndikim pozitiv prapë duke u nisur prej rasteve të fundit që kanë ndodhur janë disa aksidente me fatalitet. Unë e hap mundësinë e diskutimit rreth raportit.

z. Liman Zeqiri, çdo udhëtim në vijën rrugore përkatësisht në pikën kritike që e potencoi komandanti në atë pjesë të rrugës është me rrezikshmëri. Aty ndodhin ndeshje të shumta të automjeteve që përcjellën edhe me fatalitet. Do të ishte mirë që Drejtoria e Pronës Kadastrit dhe Gjeodezisë-DPKGJ të konstatoj çështjen e pronësisë ku është i vendosur objekti i cili është edhe shkaktarë i rrezikut, për shkak se është e pamundur të ketë pamje të mjaftueshme në atë hapësirë. Ka raste të shumta me fatalitet për shkak të atij objekti dhe duhet patjetër të intervenohet.

z. Faik Muçiqi, pika kritike e rrugës Podujevë- Shajkoc që është duke u diskutuar është kompetencë e Ministrisë së infrastrukturës dhe ky problem disa herë i është përcjellë Ministrisë dhe DPKGJ sa jam në dijeni ka bërë incizimin e pronës publike dhe është duke u marrë me atë çështje, pra aty përveç shpejtësisë së vozitjes ka probleme të shumta. Aty është menduar që të bëhet një gjysmë rreth, tani nuk jam në dijeni se deri ku është proceduar kjo çështje. Nga ky takim mund të dalim me një konkluzion që edhe njëherë Ministrisë së infrastrukturës- Drejtorisë së Rrugëve ti paraqesim këtë shqetësim, që është më aktual sepse problemet në komunikacion janë bukur të mëdha por ajo çfarë mbetet si obligim i yni është që të definojmë pronën dhe besoj se DPKGJ këtë e ka bërë.

Sa i përket emërtimeve të reja të rrugëve që janë bërë në bashkëfinancim me Bashkimin Evropian, unë kam pranuar një kërkesë nga Policia dhe pak ka qenë e çuditshme që ka informacione se nuk është listë zyrtare, ndërsa kjo listë është miratuar në Kuvendin e Komunës dhe nuk ka asnjë dilemë se emërtimet e rrugëve janë miratuar në Kuvend dhe i kanë kaluar të gjitha procedurat. Tani ka filluar implementimi me probleme të shumta të vendosjes në qytet. Mund të jenë pengesa thjesht urbanistike, por drejtori i Drejtorisë së Planifikimit Urban Mbrojtjes së Mjedisit ka marr përsipër që tua dërgoj.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, fjalën e ka përfaqësuesi i KFOR-it që të na informoj rreth gjendjes së sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës.

Përfaqësuesi i KFOR-it, nuk kemi asgjë të veçantë të shtojmë, që nga mbledhja e kaluar gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Podujevës është e qetë dhe e sigurt. Kemi bashkëpunim shumë të mirë me Policinë e Kosovës, nuk kam diçka tjetër për të shtuar.

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, në emër të anëtarëve të KKSB-së falënderoj KFOR-in për angazhimin për sigurinë e kufirit në përgjithësi. Sa i përket shqetësimit të kryqëzimi i rrugës shtëpi-Shajkoc, z. Faik Muçiqi e arsyetoi se kjo për nga kompetenca i takon Ministrisë së Infrastrukturës sepse është rrugë rajonale, megjithatë besoj se ne si Komunës kemi obligim dhe mendoj se është e nevojshme ngritja e një ekipi në përbërje të ekspertëve të Drejtorisë së Planifikimit Urban dhe Mbrojtjes së Mjedisit, të Pronës dhe të Shërbimeve Publike që të bisedojnë fillimisht me pronarin, sepse aty nuk është ndonjë objekt i banimit por është një objekt dytësor, për të kërkuar ndonjë zgjidhje nga ana e tij, por nëse është i vendosur në pronë publike atëherë të ndërmerren masa si institucion. Nëse nuk keni diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

4. Informatë për sigurinë në shkollë

z. Nexhmi Rudari, Nënkryetar i Komunës, çështjen e sigurisë nëpër shkollë paraprakisht e përmendi edhe Komandanti. Siguria në shkollë nuk është çështje që i takon vetëm Policisë së Kosovës apo Drejtorisë së Arsimit, apo vetëm një shkollë në veçanti, por çështje që na takon të gjithë neve, sepse në një formë jemi të ndërlidhur me shkollë. Obligim i yni është të sigurojmë qetësinë e plotë për nxënësit por edhe për mësuesin dhe prindërit. Drejtoria e Arsimit ka përgatitur një informatë por nuk do të thotë që ne do të ndalemi vetëm në këtë informatë, por duhet të shohim cilat do të jenë masat që duhet të ndërmarrim në bashkëpunim me shkollat që të përmirësojmë sigurinë jo vetëm në shkollë por edhe jashtë tyre. Ne e dimë që problemet që mund të ndodhin në shkollë janë të lidhura me personat që janë jashtë shkollave. Fjalën e ka z. Avni Maloku.

z. Avni Maloku, Mbrojtja e shëndetit, siguria dhe mirëqenia e nxënësve dhe e kuadrit në shkollë është një ndër detyrat e përgjithshme të Drejtorisë së Arsimit në Podujevë, e cila gjithashtu mbanë përgjegjësinë kryesore për planifikimin, caktimin e standardeve dhe sigurimin e cilësisë së sistemit të arsimit para universitar.

Përmirësimi i sigurisë në shkollë dhe forcimi i ndjenjës së pronësisë qytetare për zgjidhjen e problemeve të sigurisë dhe për të krijuar një mjedis më të sigurt dhe sistem më efektiv arsimor është dhe vazhdon të mbetet një ndër angazhimet e vazhdueshme të punës së Drejtorisë së Arsimit.

Komuna e Podujevës, sipas statistikave në muajin gusht 2016 ka gjithsej 19762 nxënësit në të gjitha nivelet (1 çerdhe publike për fëmijë, 36 shkollë fillore dhe të mesme të ulëta, 2 shkollë të mesme të larta profesionale dhe 1 gjimnaz). Nga numri i përgjithshëm 19687 (10124 meshkuj dhe 9513 femra) janë shqiptarë, 121 nxënësit ashkali (60 meshkuj dhe 61 femra), dhe 4 nxënësit rom (1 mashkull dhe 3 femra).

Përkundër vlerësimit të gjendjes së sigurisë në institucionet edukativo-arsimore në Komunën e Podujevës, shqetësimet e qytetarëve megjithatë janë të pranishme, natyrisht incidentet e rralla që ndodhin në shkollë apo rreth tyre në vazhdimësi paraqesin shqetësim për nxënësit, mësuesin, prindërit, por edhe për vetë institucionet.

Duke qenë se nxënësit pjesën më të madhe të kohës e kalojnë në ambientet shkollore është shumë e rëndësishme që jo vetëm për mirëqenien e tyre por edhe për vetë procesin edukativo-arsimor të ketë siguri të lartë në shkollë.

Natyrisht, se janë një seri faktorësh të cilët ndikojnë në krijimin e bindjeve dhe perceptimeve të sigurisë në shkollë, e që Drejtoria e Arsimit është e përkushtuar në eliminimin e rreziqeve me të cilat mund të ballafaqohen nxënësit.

Çështjet në të cilat është e fokusuar Drejtoria e Arsimit kanë të bëjnë me:

- krijimin e infrastrukturës bashkëkohore të shkollave;
- ndriçimi lokaliteteve në afërsi të shkollave dhe oborrit të shkollave,
- eliminimi i rreziqeve që paraqiten në komunikacion, rregullimi i trotuareve,
- eliminimi i dukurive negative: në shkollë (grupacionet e të rinjve, jo nxënësit në afërsi të shkollave, ngacmimet e nxënësve, dhuna, si dhe prania e armëve të ftohta në shkollë),
- vetëdijësimi i nxënësve për rrezikun që paraqesin dukuritë negative (narkotiket, prostitucioni, alkooli, duhani, bixhozi etj.);

- Eliminimi i rreziqeve nga qentë endacak, sidomos gjatë stinës së dimrit.

Numri i përgjithshëm i shkollave në Komunën e Podujevës i plotësojnë kushtet për organizimin e procesit mësimor, me përjashtim të tri shkollave, të cilat janë në proces të ndërtimit.

Për ngritjen e nivelit të sigurisë së shkollave, DA ka rregulluar rrethojat e oborrit të shkollave (24 institucione arsimore kanë rrethojë në gjendje të mire, kurse në 16 shkolla rrethoja është e pjesshme ose e dëmtuar. Kujdes i veçantë për ndriçimin e shkollave dhe lokaliteteve rreth tyre i është kushtuar shkollave në zonën urbane, ku mbi 45% e numrit të përgjithshëm të nxënësve në Komunën e Podujevës gravitojnë në këto zona (urbane). Për të gjithë nxënësit e arsimit fillor dhe të mesëm të ulet që kanë distancë më të largët se 4 km deri në shkollën më të afërt, Drejtoria e Arsimit siguron transportin. Po ashtu në afërsi të shkollave janë vendosur sinjalistika adekuate që paralajmërojnë zonat shkollore, si dhe në disa zona ku rreziku është më i lartë nga komunikacioni janë rregulluar edhe stazat për këmbësor (trotualet), e që kjo do të vazhdojë edhe më tutje. Prania e dukurive negative në shkolla mbeten sfidë dhe ajo mund të jetë e pranishme në formë të ndryshme si: grupacionet e të rinjve jo nxënës në afërsi të shkollave, ngacmimet e nxënësve, dhuna, si dhe prania e armëve të ftohta në shkolla narkotikët, prostitucioni, alkooli, duhani, bixhozi etj. Për t'i përballuar me sukses këto sfida, DA dhe institucionet edukativo-arsimore, zhvillojnë bashkëpunim të ngushtë me të gjitha palët e interesit, si: komuniteti i prindërve, institucionet e sigurisë, Qendra për punë sociale, OJQ e ndryshme. Në institucionet edukativo-arsimore janë të formuara dhe funksionale organet qeverisëse dhe profesionale që merren me eliminimin e dukurive negative në shkolla, si dhe zhvillojnë fushata dhe aktivitete të ndryshme për vetëdijesimin e të rinjve për rrezikun që paraqesin dukuritë negative (Këshilli drejtues i shkollës, Këshilli i prindërve, Këshilli i nxënësve, Këshilli i arsimtarëve, Kujdestarët e klasave, Ekipet e ndryshme shkollore etj.). Në disa zona rurale si rrezik potencial paraqiten edhe qentë endacak. Zgjidhjen e këtij problemi DA e sheh në bashkëpunimin e ngushtë me shoqatën e gjahtarëve, si dhe sigurimin e transportit të organizuar.

DA, përkushtim permanent për sigurinë në shkolla do ta ketë:

Sigurimin e mekanizmit përcjellës për zbatimin e plotë të kodit të mirësjelljes;

Të trajtojë çështjet e sigurisë si pjesë të integruara të vetë procesit mësimor duke siguruar kështu punën normale nëpër shkolla ku liria dhe siguria e nxënësve nuk do të cenohej;

Rritja e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve përkatëse: shkolla, Qendra për punë sociale, Shërbimet korrektuese, Policia, Prokuroria, Gjykata, Prindërit, etj.;

Rritja e investimeve në infrastrukturën e shkollave dhe objekteve përcjellëse;

Promovimi dhe krijimi i kushteve për kultivim të kulturës së debatit ndërmjet mësimdhënësve dhe nxënësve për të bërë të mundur zgjedhjen më të shpejtë dhe më të lehtë të problemeve të përditshme të shkollave;

Funksionalizimi dhe fuqizimi i organeve të shkollave duke mundësuar kështu ushtrimin që i ka përcaktuar ligji në fuqi;

z. Faik Muçiqi, po ndalem më tepër te infrastruktura përcjellëse që përkon me Drejtorinë e Shërbimeve Publike Mbrojtjes dhe Shpëtimit, por fillimisht dua të ndalem te të dhënat statistikore të numrit të nxënësve që janë dhënë, kam pak dilemë. Ka shpërputhje të numrit të përgjithshëm të nxënësve, përfshirë edhe numrin e përgjithshëm të meshkujve dhe femrave, kjo gjendje nuk përputhet, kjo duhet rregulluar për hirë të statistikës. Sa i përket ndriçimit në qytet, kësaj çështjeje i është kushtuar bukur shumë, posaçërisht afër shkollave, tani është në procedurë edhe një projekt tjetër nga SHFMU” Naim Frashëri “ deri te QKMF, ndërsa në fshatin Letanc, te shkolla veç është përafëruar. Trotuare janë ndërtuar bukur shumë mbi 25,000 m², përafërsisht 20 km gjatësi, trotuare që kryesisht janë afër shkollave, duke filluar nga fshtrat Batllavë, rajoni i fshtrave Bajqinë, Dobërdol, Zakut, Metehi, Dumnicë, Lladoc, Shajkoc etj. Për hirë të sigurisë së nxënësve, pavarësisht që në shumë rrugë ka për obligim të merret Ministria e Infrastrukturës, duke parë të nevojshme kemi ndërhy nga buxheti i Komunës. Sigurisht kjo duhet të vazhdojë, posaçërisht trotualet dhe ndriçimi. Problemin e qenve endacak e kemi diskutuar pothuajse në çdo nivel, por sigurisht jeni në dijeni lidhur me problemet që kemi me legjislacionin aktual, problem është gjendja faktike dhe jo vetëm këtu por në të gjitha komunat, është tepër shqetësuese dhe anashkaluese kjo dukuri, megjithatë ne kemi një arsyetim edhe nga AUK-u që në raste të caktuara të intervenohet, andaj kemi zhvilluar procedurat e prokurimit, sepse është e patolerueshme që para shkollave apo institucioneve tjera publike të gjenden në grumbuj qen të rrezikshëm, andaj këtë shqetësim të nxënësve dhe banorëve shpresojmë se do ta pakësojmë.

z. Liman Zeqiri, shtroi pyetje, në shkollat e mesme sa nxënës kanë mbetur jashtë bankave shkollore, sepse mendoj se është një numër i konsiderueshëm që ende nuk janë sistemuar dhe sa janë gjasat që ata nxënës të mos bredhin rrugëve dhe të inkuadrohen në procesin mësimor. Shqetësim tjetër, përveç atyre që përmendi z. Faik Muçiqi janë dukuritë negative në shkollë. Kjo është një brengë e madhe që na shqetëson shumë, ku në këtë kohë moderne, ta quaja të demokracisë, tani vijnë në shprehje rreziqe të shëmtuara si droga, prostitucioni, alkooli. Në këtë drejtim kemi obligim moral dhe njerëzor, të gjitha institucionet, OJQ-të të japim kontributin, të ketë më shumë trajnime, ngase kjo është një dukuri devijante, shkatërrimi i rinisë së një populli është shkatërrimi më i madh. Nëse ne në këtë kohë nuk ndërmarrim masa preventive, dikur do të jemi vonë, me pasoja të pashërueshme.

z. Fadil Halimi, arsimin në Komunën tonë dukuritë negative e kanë përcjellë që nga përfundimi luftës, gjithherë është përballur me grupe të ndryshme të huliganizmit, të cilat kanë penguar procesin mësimor. Këto grupe ndërkohë kanë filluar të largohen nga hapësirat e objekteve shkollore pas angazhimit të Policisë në rroba civile. Grupe të tilla kanë filluar prapë dhe ne mbështetjen e kemi vetëm në Policinë. Pran shkollave mund të ketë përdorim të duhanit, alkoolit, prani të armëve, kjo është një sfidë që është duke na përcjellë me vite. Në informatë kemi shprehjen prostitucion, nuk e di se çka është nënkuptuar me atë, sipas informatës alkool mund të ketë jashtë objekteve shkollore, ngase ka shumë lokale ku shërbejnë alkool dhe ne nuk kemi qasje të mjaftueshme, mirëpo edhe inspeksioni herë pas here duhet ti kontrollojë ato lokale. Kjo duhet bërë nga mekanizmat e sigurisë siç është Policia dhe kompetentët tjerë, ndërsa dukuria e prostitucionit nuk besoj se është prezente. Shtrohet pyetja se çka mundemi ne si KKSB të ndërmarrim për evitim e të gjitha këtyre dukurive negative që janë duke e përcjellë arsimin, në veçanti në shkollat e mesme, a mundemi të përgatisim një plan konkret që i referohet sigurisë në shkollë në përgjithësi, fjala vjen a është e mundur që të ketë prani më të madhe të policisë civile dhe të jetë prezentë më gjatë, kjo do të ngritë efektin e sigurisë.

z. Shaban Ahmeti, nuk kam diçka për të shtuar rreth sigurisë por desha të falënderoj Kryetarin e Komunës dhe drejtorin e Drejtorisë së Arsimit për shpërndarje falas të 61 kompleteve të librave për nxënësit e shkollave të mesme të komunitetit ashkali.

z. Liman Zeqiri, çështjen e numrit jo të mjaftueshëm të zyrtarëve policorë e kemi biseduar edhe më herët, mirëpo po ndërlidhem me çështjen e trotuareve. Jemi dëshmitar okularë të gjithë këtu që me të vërtetë është e tepruar, edhe pse policia vepron, automjete ka shumë nëpër trotuare dhe këtu është në pyetje vetëdija jonë dhe ndërgjegjja. Është e pamundur qytetarët të ecin nëpër trotuare për shkak të automjeteve dhe kjo është shqetësuese, sidomos kur është në pyetje pran shkollave dhe këtu fëmijët e vegjël i ekspozohen rrezikut nga automjetet për shkak të ecjes nëpër rrugë. Për komandantin kam një kërkesë edhe pse jam në dijeni për numrin e pamjaftueshëm të zyrtarëve policor që të ndërmerren masa pak më të ashpra sidomos te shkollat ku janë nxënësit më të vegjël. Trotualet janë për ecje e jo për vendosje të automjeteve.

z. Avni Maloku, theksoi, këtë vit shkollor kemi pasur një fluks apo numër shumë më të madh të nxënësve që kanë përfunduar semimaturën. Kjo gjeneratë ndodh që ti ketë 2003 nxënës dhe me të vërtetë ka qenë një sfidë edhe për Drejtorinë e Arsimit dhe Komunën, ngase normalisht duhet të ketë kapacitet të shtuar edhe të kuadrit dhe të hapësirave, mirëpo kemi arritur që të sigurojmë vende për të gjithë nxënësit. Asnjë nxënës nuk është jashtë bankave shkollore, përveç atyre që nuk dëshirojnë të shkojnë. Të gjithë nxënësit janë sistemuar duke marrë përbazë kriteret bazike të pranimin në shkollat përkatëse, por edhe kemi shtuar numrin e nxënësve në paralele, ndërsa sa i përket shifrave të numrit të nxënësve, për mos përputhje të numrit siç e potencoi z. Faik Muçiqi, kjo është një lëshim teknik dhe do të korrigjohet. Atë që theksoi z. Fadil Halimi, rreziqet nuk janë nënkuptuar si dukuri aktuale por janë potencuar si rreziqe në kuptimin për vetëdijesimin e nxënësve e jo në kuptimin që janë.

Edhe pse në informatë nuk është përfshirë që javën tjetër do të fillohet me disa projekte dhe programe me ndikim për ngritjen e vetëdijes së nxënësve.

z. Bekim Bislimi, pajtoj me diskutimin e z. Liman Zeqirit, fatkeqësisht ka aksidente me fatalitet edhe përkundër angazhimit tonë. Në raport me vitin e kaluar kemi numër shumë më të madh të shqiptimit të kundërvajtjeve. Nëse përpjesëtohet numri i zyrtarëve policor me kokë të banorit rezulton një shifër alarmante. Në raste të shpeshta ndodh të jem i detyruar t'i anulojë pushimet e zyrtarëve policorë për t'u marrë me parandalimin e aktiviteteve kriminale dhe dukurive negative. Javën e kaluar në bashkëpunim me inspektorë kemi filluar aktivitetin dhe gjendja është më e mirë në veçanti rreth objekteve shkollore dhe ky aktivitet do të vazhdoj. Jemi në proces për rritjen e numrit të zyrtarëve

policorë të cilët do të merren ekskluzivisht vetëm me komunikacion. Ndërsa sa i përket problemeve në shkolla ato vetëm se u potencuan.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, kam qenë drejtor i Drejtorisë së Arsimit dhe njohë problematikën në këtë fushë. Përgjegjësia e sigurisë në shkolla nuk mendoj se i takon vetëm policisë. Mendoj se dhuna në shkolla ndodhë në çdo moment, dhunë është jo vetëm dhuna fizike, dhunë është edhe atëherë kur një mësuesdhënësi i papërgjegjshëm nuk e mban orën e mësimit, nxënësit i dalin jashtë kontrollit, sepse nëse ai nuk e mban orën nxënësit i dalin jashtë oborrit të shkollave dhe në këtë rast ata janë material potencial për të shkaktuar probleme çoftë mes veti apo me persona të tjerë. Ne si Këshill mund t'i rekomandojmë Drejtorisë së Arsimit që realisht t'i aktivizoj këshillat e nxënësve në shkolla, këshillat e prindërve. Ne patëm filluar me instalimin e kamerave, ato kanë një efekt parandalues dhe pozitiv, por nuk janë zgjidhje sepse dhuna mund të ndodhë larg kamerave. Çështja e trotuareve, nga raporti pamë se sa mijë metra janë shtruar dhe sa janë funksionale. Çështjen e trotuareve në rrugë rajonale nuk e kemi edhe aq problem, nuk ka automjet të parkuar rrugës për në Merdarë, ne problemin e zënies së trotuareve e kemi në qytet dhe jo vetëm me automjete por edhe me mjete të tjera. Ka raste të shumta që sasi e druve për djegie qëndrojnë gjatë në trotuare. Dmth. kjo është ajo që neve po na ndodhë. Kam bindje që policët kur nuk e kanë detyrë obligative, kur nuk urdhërohen prej eprorit ata kalojnë pran tyre dhe nuk i vërejnë ato. Kërkoj nga ju që të gjithë zyrtarët policor, çoftë ata që e kanë si obligim por edhe ata që nuk e kanë obligim, të lajmërojnë menjëherë rastin dhe të merren veprimet përkatëse. Ne si komunitet t'i bashkërendisim veprimet, me një koordinim më të mirë dhe bashkëpunim duke filluar prej mekanizmave që i përmenda në shkollë deri te Policia. E them nga përvoja se kam pas shpesh herë raste që kam qenë i informuar se në shkollë ka armë të ftohta dhe kur e kam thirrur drejtorin ai këtë e ka mohuar dhe ka raportuar se gjithçka është në rregull dhe kjo është bërë nga frika që atij mos ti dal në raport si keq menaxhim apo nuk është në gjendje të menaxhojë situatën e krijuar. Ajo është gjëja më keqe që mund ti shkaktojmë veti si shoqëri. Në rend të parë ata janë përgjegjës për sigurinë e fëmijëve. Çështja e qenëve endacak sikur se e potencoi z. Faik Muçiqi problem më të madh do ta kemi në fshatra, tani në periudhën e dimrit por fatkeqësisht kjo çështje është e rregulluar me ligj. Me këtë e përmbylli këtë pikë të rendit të ditës nëse dikush nuk ka diçka për të shtuar kalojmë në pikën e radhës.

5.Informatë për rastet e kthimit dhe integritetit të qytetarëve në shtëpitë(pronat)e tyre

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fjalën e ka z. Ylber Salihu, zyrtar për integritet evropiane.

z. Ylber Salihu, duke u bazuar ne Rregulloren 04/2016 për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar dhe Menaxhimin e programit të Riintegritetit, personat të cilët mund të përfitojnë nga ky program të gjitha kërkesat e tyre duhet të paraqiten brenda 6 muajve nga dita e Riatdhesimit përveç kërkesës për themelim biznesi që është 12 muaj nga data e Riatdhesimit. Kërkesat e personave të Riatdhesuar janë të ndara në tri kategori:

I. Personat që kanë lëshuar Kosovën para datës 28.07.2010 dhe janë Riatdhesuar në vitin 2016 mund të përfitojnë:

- 1.Themelim Biznesi
- 2.Rindërtim apo renovim të shtëpisë
- 3.Banim përmes qirasë
- 4.Asistencë sociale
- 5.Pako për dimër
- 6.Trajtim mjekësor
- 7.Pako e orendive shtëpiake.

II. Personat që kanë lëshuar Kosovën gjatë vitit 2014 dhe 2015 dhe janë Riatdhesuar në vitin 2016 mund të përfitojnë:

- 1.Themelim Biznesi
- 2.Pako ushqimore dhe higjienike.

III. Personat e Riatdhesuar që janë rast i cenueshëm të cilët së paku 1 vit kanë jetuar jashtë Kosovës dhe kanë nevojë për masa të veçanta të Riintegritetit si pasojë e kapacitetit të tyre të zvogëluar

funksional, për shkak të sëmundjes apo aftësive të kufizuara, moshës, nënat vet ushqyese apo edhe si pasojë e gjendjes së tyre familjare apo problemeve tjera.

Vlerësimi i rasteve të cenueshme bëhet përmes dokumentacionit që posedojnë personat e Riatdhesuar dhe vizitës në teren.

Gjatë periudhës Janar- Shtator 2016 në Komunën tonë janë lajmëruar 2046 persona të Riatdhesuar ku 60% e tyre janë familje ndërsa 40 % janë raste individuale.

Të gjithë këta persona i kam informuar në detaje lidhur me Programin e Riintegritit dhe mundësit e përfitimit nga ky program.

Nga këta persona deri më tani kanë marrë konfirmime të Riatdhesimit 759 persona me qëllim të ndjekjes së trajnimit mbi afësimin profesional për vetëpunësim në Qendrën e Aftësimit Profesional në Prishtinë, që është e obliguar të certifikohen dhe pas certifikimit ne ju ndihmojmë në kompletimin e lëndës dhe përmes zyrës tonë aplikojnë në Ministrinë e Punëve të Brendshme MPB - Departamenti për Riintegrimin e Personave të Riatdhesuar DRPR për financim të Bizneseve të reja në vlerë prej 3000 €.

Gjatë kësaj periudhe i kemi dorëzuar 86 lëndë për Themelim Biznesi në Ministrinë e Punëve të Brendshme MPB-DRPR ku 25 prej tyre janë aprovuar, 5 janë refuzuar dhe të tjerat pritet të shqyrtohen nga Komisioni Qendror për Riintegrim KQR në Ministrinë e Punëve të Brendshme MPB-DRPR.

Po gjatë kësaj periudhe i kemi strehuar 6 familje që kanë qenë raste të cenueshme që kanë përfituar strehim trajtim mjekësor dhe medikamente.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, a ka dikush diçka lidhur me informatën e paraqitur, nëse jo kalojmë në pikën e radhës dhe të fundit, nëse keni ndonjë propozim apo çështje.

6. Të ndryshme

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, fjalën e ka z. Bekim Jashari.

z. Bekim Jashari, i bashkëngjitëm shqetësimeve që u diskutuan, kisha mundësinë që të ndërhyjë në pikën 3 të rendit të ditës por qëllimisht u rezervova që të jap një pasqyrim të asaj në mënyrë që edhe ky Këshill të jetë në dijeni. Sikurse në të kaluarën edhe tani Bashkësia Islame në Komunën tonë vazhdon të qëndroj në parimet dhe vizionin e saj që të punoj për parandalimin e dukurive të një islami ndryshe, e veçanërisht nga ato organizata me tendencë për të shtrirë një ideologji ndryshe nga ajo shqiptare. Dëshiroj të jap qartësimin para jush, por në të njëjtën kohë edhe një shqetësim të vogël në lidhje për mos reagimin e duhur të gazetarëve nga Podujeva apo mos informimin e opinionit publik të Republikës së Kosovës në lidhje me qëndrimet e Bashkësisë Islame në raport me një OJQ që është hapur në Podujevë. Bashkësia Islame as nuk ka bashkëpunuar as nuk bashkëpunon me asnjë OJQ qoftë nga Turqia apo nga ndonjë vend tjetër dhe nuk i bartim përgjegjësitë tona një institucioni të huaj, qoftë turke, arabe apo çfarëdo qoftë, sepse llogarisim që kemi staf, kemi kuadër, kemi njerëz të dëshmuar në BI dhe nisur nga parimi parandalimi i çështjeve është më i mirë se sa të diskutohet më tutje për atë që mund të ndodhë. Gazetarët nga Komuna e Podujevës nuk kanë raportuar për opinionin e shtetit dhe nuk jam në dijeni për arsyet. Ne si Bashkësi Islame kemi marrë qëndrim që cili do imam i cili bashkëpunon, koordinon, sjell rryma tjera ne do të hapim raste disiplinore ndaj tyre dhe në këtë drejtim edhe si udhëheqës në mandatin e dytë të KBI jam i vendosur të punoj më fuqishëm. Ne jemi në përpjekje për identifikimin e numrit të personave që mund të jenë të infiltëruar apo që mund të kenë prirje me ideologjinë ekstreme. Ndoshta shqetësimi ishte rreth ngjarjeve nëpër shkolla edhe për kundër asaj se ka progres në shkolla. Organizata në fjalë që e përmenda, që veç është hapur në Podujevë është mirë të dihet se ajo jo vetëm që ka institucion paralel ndaj BI të Komunës ajo ka edhe shkollë brenda. Për fatin e keq kemi nxënës që e kanë ndërprerë klasën e nëntë dhe janë duke vazhduar shkollën në konviktet e tyre në Prizren. Kjo është diçka që është shqetësuese, sepse për ne primare është shkolla, prezenca e fëmijëve në shkollë sesa kur na vijnë në xhami dhe për këtë arsye ne kemi bërë të mundur që tani në Xhaminë e Qendrës të falen dy xhuma në mënyrë që nxënësit mos të kenë si pretekst dhe të ikin nga shkolla dhe mësimdhënësit tanë nuk duhet të jenë të mëshirshëm dhe ta lirojnë nxënësin nga shkolla dhe kjo të bëhet praktikë dhe fjala vjen të shkoj nxënësi në xhami në klasën e gjashtë. Ne nuk e mbështesim këtë praktikë dhe ne nuk kërkojmë asnjëherë një gjë të tillë. Për ne fëmijë i suksesshëm në shkollë është sukses për vendin. Ikja e tij nga shkolla dhe ardhja në

xhami për mua është i panevojshëm. Në këtë drejtim BI po e përsëris qëndron fuqishëm larg ideologjive. Lufta kundër organizatave ekstremiste dhe terroriste mund të mbaroj, mirëpo lufta kundër ideologjisë që është në tentim për tu shtrirë në botë kjo nuk mbaron. Në këtë drejtim unë jam shumë i kënaqur me bashkëpunimin e Këshillit të Bashkësisë Islame të Podujevës me Institucionet relevante të Komunës, me komandantin e Stacionit të Policisë etj. Mendoj por është edhe dëshirë që OSBE, përfaqësuesi i saj në Komunën tonë të jetë pak më aktiv në disa organizime, jo vetëm të mbetet si zyrë, ngase ne fundja nuk kemi nevojë vetëm të monitorohemi por edhe që të bëjnë hapa konkret. Në disa komuna tjera OSBE organizojnë fushata senzibilizuese për çështje të ndryshe përfshirë edhe çështjen e ekstremizmit, pra është mirë që edhe këtu të sjellin diçka konkrete. Lufta kundër elementëve të ekstremizmit nuk ka mbaruar, ju mund të hasni në individ të caktuar që kanë studiuar fenë të cilët ndoshta e kanë një mendim por edhe që transmetojnë te qytetarët se nuk ka rrezik. Komuna e Podujevës qëndron mirë në këtë çështje dhe ka emër në këtë aspekt që është e suksesshme, mirëpo prapa kësaj mund të kemi një rrezik tjetër, njerëzit që kanë shkuar dhe kthehen nga konfliktet mund ta gjejnë si strehë të fshehtë Komunën tonë sepse vëmendja nuk është kah Podujeva për faktin që qëndrojmë mirë dhe bëj thirrje në këtë drejtim që të jemi syçelë dhe të vëmendshëm.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, parafolësi ka prekur disa çështje që besoj se të gjithë jemi të shqetësuar dhe të interesuar të japim kontributin.

z. Bekim Bislimi, në kontekst të asaj që u diskutua jemi në përgatitje e sipër të një ligjërate si pjesë e atij aktiviteti, e cila planifikohet të mbahet brenda muajit nëntor pikërisht për këtë temë. Dua të ndërlihem edhe me çështjen që theksoi Nënkyetari e që pajtoj plotësisht se policia nuk është shkop magjik por vepron dhe është në koordinim me të gjitha institucionet relevante sa i përket çështjes së sigurisë, por ka hapësirë për punë më të mirë në aspektin profesional. Nënkyetari gjithashtu potencoi çështjen e zënies së trotuareve nga automjetet, kur jemi te policia ka shumë në mesin e tyre që nuk i takojnë Stacionit Policor, por qytetarët nuk janë në dijeni se cilit institucion i përkasin, kemi Stacionin në Kërpimëh, Lluzhan, por edhe zyrtarë policor nga Niveli qendror, që janë me përgjegjësi të ndara.

z. Nexhmi Rudari, Nënkyetar i Komunës, shihet se situata e sigurisë në Komunën e Podujevës është stabile dhe e qetë, megjithatë kurrë nuk ka mjaft siguri, gjithmonë duhet të jemi pro aktiv dhe ti paraprijmë proceseve e jo të merremi me pasojat. Çështja e sigurisë në çdo komunitet është jetike, ajo është një garancë për zhvillim ekonomik, politik, social etj. megjithatë këtë çështje nuk duhet ti ja lëmë vetëm Policisë, porse siguria është përgjegjësi e secilit prej nesh si individualisht por edhe përgjegjësi zyrtare, sepse si Komunë kemi përgjegjësi të caktuara lidhur me çështjen e sigurisë.

Nënkyetari përfundoi mbledhjen pasi që nuk pat çështje tjera për shqyrtim, ndërsa të pranishmit i falënderoi për pjesëmarrje dhe kontribut.

Mbledhja përfundoi në orën 11.35

Procesverbalin e mbajti

Sabedin Namani

Nr. 02-016-79982

Podujevë,

26 tetor 2016

Kryetari i Komunës

Agim Veliu